

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FRIENDS AUTO “ sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 13/01/2023 te poshteshenuarit ,

Dorian PULASHI lindur me 05/02/1983, ne Shqiperi , nenshtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit karte identiteti I30205132Q dhe banues ne Rrugen Vorpsi, Ndertesa 5, Hyrja nr 3, Apt 5, Selite, Tirane, Shqiperi,

dhe

Fation GREMI lindur me 01/08/1989, ne Shqiperi , nenshtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit karte identiteti I90801022H dhe banues ne Rrugen Grigor Heba, Ndertesa 11,H.1, Apt 7 , Tirane, Shqiperi,

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ kemi rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi të mëposhtëm, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar(më poshtë shoqëria) aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj i cili është pjesë përbërëse e ketij akti, të cilit i bashkëngjitet (më poshtë shtojca 1).

Neni 1
Emertimi

Emërtimi i Shoqerisë është “**FRIENDS AUTO** “ sh.p.k.

Neni 2
Selia

Shoqëria e ka selinë në , Rruga Robert Shvarc , Kompleksi Niku , Tirane , Shqiperi. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë se shoqërisë do të për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqeria “**FRIENDS AUTO** ” shpk do te ketë si objekt kryesor të veprimtarise së saj:

- ✓ Shitblerje automjetesh dhe mjete te ndryshme motorike .
- ✓ Shitblerje te autovegurave, motomjeteve dhe pajisjeve ndihmese te tyre.
- ✓ Shitblerje te pjeseve te ndryshme per mjete motorike
- ✓ Sherbime dhe te tjera veprimtari te ndryshme te lidhura me mjetet motorike.
- ✓ pakice te mjeteve te transportit dhe makinerive te ndryshme.



Veç sa më sipër shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tregtar dhe industrial, në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar dhe të huaj.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 1,000,000 (Nje milion) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale 500,000(Peseqind mije) lekë secila.

Keto kuota kapitali jane te shlyera tërësisht dhe mbajtës/ pronar i këtyre kuotave jane ortaket

a)-z. Dorian Pulashi , pronar i 1 (nje) kuote kapitali me vlere nominale 500,000(Peseqind mije) lekë, ose 50 % te kapitalit.

Dhe

b)- z. Fation Gremi , pronar i 1 (nje) kuote kapitali me vlere nominale 500,000(Peseqind mije) lekë, ose 50 % te kapitalit.

Neni 6

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit i tranferohen të tretëve sipas parashikimeve të statutit.

Neni 7

Administrimi

Administrator i shoqërisë do te jete Z.Dorian PULASHI lindur me 05/02/1983, ne Shqiperi , nenshtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit karte identiteti I30205132Q dhe banues ne Rrugen Vorpsi, Ndertesa 5, Hyrja nr 3, Apt 5, Selite, Tirane, Shqiperi, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 8

Kompetencat

Administratori ka te drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të

shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje për llogari të kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 9

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "FRIENDS AUTO" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

DORIAN PULASHI

Dorian Pulashi



FATION GREMI

Fation Gremi

